



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. _____
Nr. i faq. _____
Broj stranica _____
Nr. _____

Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot No. _____
Data _____
Datum _____
Date _____

DPK
03
03-03/3039/17
04.10.2017

DATE/A:	04.10.2017
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-2819/17
PËR/ZA/TO:	z. Afrim BAJRAKTARI, Drejtore i Departamentit të Prokurimit në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina “
CC:	z. Esat KELMENDI, Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës “ Hasan Prishtina “
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Instalimi i Kamerave në Rektorat "

I nderuar z. BAJRAKTARI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Instalimi i Kamerave në Rektorat ", me numër të prokurimi: 242-17-4461-221, me nr. të brendshëm: 90400-17-059-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Instalimi i Kamerave në Rektorat ", me numër të prokurimi: 242-17-4461-221, me nr. të brendshëm: 90400-17-059-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 27.10.2017, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-2819/17*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Instalimi i Kamerave në Rektorat*", me numër të prokurimi: *242-17-4461-221*, me nr. të brendshëm: *90400-17-059-221* i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Agjencia duke u bazuar në dokumentet e nxjerra nga platforma E-Prokurimi ka analizuar me kujdes Njoftimin për kontratë, Dosjen e Tenderit ku ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti kontraktues ka paraparë Instalimin e kamerave në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, duke përdorur procedurën e hapur të prokurimit, kontratë të llojit shërbime me vlerë të mesme të kontratës, ku hapja e tenderit është paraparë të bëhet me datën 12.10.2017.

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit kontraktues, tek rubrika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional tek pika 2 është kërkuar që "Ofertuesi duhet të prezantoj 3 kontrata të përfunduara për vitet (2014,2015 dhe2016)", ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare pika 2 është kërkuar që ofertuesi duhet të prezantoj Listën e kontratave së bashku me 3 referenca për punë të ngjashme për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të sistemeve të kamerave në Institucionet Publike të realizuara në tri vitet e fundit për furnizime të ngjashme, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Sipas Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Autoriteti kontraktues mundet të kërkoj kontrata dhe referenca për furnizime, shërbime dhe punë që ka realizuar Operatori Ekonomik me Institucionet Publike, Misionet Ndërkombëtare dhe Kompanitë Private, mirëpo nuk është e lejuar që të kërkojnë kontrata apo referenca vetëm me Institucionet Publike. Sipas Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik me saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 është paraparë që "Autoriteti kontraktues mundet të kërkoj listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë".

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 69 Aftësitë Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr materialin tenderik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

